


“Bota krejt e re” e Hollivudit — Po i konverton masat



drejt misticizmit

**The Berean
Call**

MARS 2010

UNJILLI I AVATARIT

nga T. A. McMAHON

THIRRJA BEREASVE

“[Bereasit] ... i shqyrtuan çdo ditë shkrimet, [për të parë] nëse këto gjëra ishin ashtu”. - VEPRAT 17:11

WWW.THEBEREANCALL.ORG

DAVE HUNT, THEMELUES

VËLL. XXV, NR. 3

MARS 2010

Ungjilli i Avatarit

T.A. McMahon

Filmat janë mjete më popullore i sotëm për ndikimin e kulturave në shkallë mbarëbotërore. Ata kanë qenë të efektshëm në këtë drejtim për pjesën më të madhe të shekullit. Ata janë dhe kanë qenë gjithmonë makina mësimi.

Edhe pse shumica e njerëzve i konsiderojnë ata thjesht si zbavitje apo një mënyrë argëtimi, prapëseprapë ata mësojnë gjithmonë diçka. Ky fakt m'u bë jashtëzakonisht i qartë në ditët e mia para se të bëhesha i krishterë, kur isha në Iran si një skenarist për një xhirim të Hollivudit. Ishte koha pak para përmbysjes së Shahut më 1979. Revolucioni ishte ndezur, në fakt, nga klerikë myslimanë që i kishin urdhëruar ndjekësit e tyre për t'ua vënë flakën kinemave (të mbushura me njerëz). Ishte një protestë kundër mësimave dhe ndikimit të kulturës perëndimore që gjendeshin në filma, veçanërisht shfaqjes së imoralitetit dhe sjelljes së degjeneruar. Me reagime dhe pasoja më pak ekstreme, asnjë vend nuk duket se nuk preket nga ndikimi i filmave, pavarësisht se ku udhëton dikush këto ditë.

Kjo është me siguri e vërtetë për një nga filmat më të shtrenjtë deri më sot, për prodhimin prej çerek miliard dollarësh të *Avatarit*, që tashmë ka nxjerrë 2 miliard dollarë. Asnjë film deri më sot nuk krahasohet me vlerën e tij tërëqëse të xhirimit në krijimin e një bote fantastike me karaktere të krijuara me kompjuter, që bashkëveprojnë dhe përshtaten vaj me aktorë fizikë dhe me botën që njohim. Besueshmëria është cilësia «e skajshme» e çdo filmi të çdo lloji dhe *Avatarit* i bën të gjithë t'i besojnë, veç kritikëve të filmave – pak prej të cilëve do të ankoheshin se ky prodhim i jashtëzakonshëm nuk u ka dhënë vlerën e parave të paguara.

Objektivi im për shkrimin e këtij artikulli nuk është që të ankojmë për xhirimin e filmit (Unë pagova çmimin e pasdites, e qytetarit të moshuar, kështu që vështirë se jam mashtruar), por më tepër të jap pikëpamjen time për teologjinë e përçarur në filmin *Avatar*. Neve të THEB na janë bërë pyetje nga prindër të shqetësuar që nuk janë të sigurt nëse do të jetë e përshtatshme për adoleshentët e tyre për ta parë dhe duan të dinë se si ta diskutojnë me ta përmbajtjen e filmit. Teologjia e *Avatarit* është shqetësimi im parësor.

Së pari, nuk duhet të jetë e çuditshme që besimet e shumicës së njerëzve nuk merren nga mësimet e takimit të fëmijëve apo ato të kishës, por më tepër ide fetare që ata mbledhin nga një larmi e gjerë burimesh ndërsa ecin në këtë jetë.

Para se të lindja përsëri dhe të bëhesha një i krishterë biblik, për shembull, kisha marrë një pjesë të madhe me udhëzime fetare, duke u rritur katolik, të cilave u shtova lloj-lloj idesh frymërore të kundërta, nga rimishërimi te mohimi i ferrit e deri te shpëtimi universal i të gjithëve. Kam patur biseda me ata që pohojnë se e pranojnë Biblën si burimin e tyre të vetëm të besimit dhe të praktikës, megjithatë pranojnë edhe ide që kanë mbledhur nga Oprah Uinfri (Oprah Winfrey) apo nga ndonjë prej të ftuarve të saj nga kulti Epoka e Re (New Age). Njerëzimi, në përgjithësi, duket se është një magnet për të gjitha llojet e besimeve për Perëndinë dhe kjo duhet të përfshijë jo vetëm fetarët, por edhe agnostikët dhe ateistët po ashtu.

Filmat mësojnë shpesh teologji. Disa i kanë ndikuar tepër dy brezat tanë të kaluar në lidhje me karakterin dhe cilësitë e Perëndisë dhe ndoshta asnjë nuk e ka bërë këtë më shumë se seria e filmave *Luftërat e Yjeve*, që filloi vonë më vitet 1970. Kjo seri e promovoi hyjninë supreme si një «Forcë» energjie jopersonale, amorale, që mund të merrej dhe të përdorej për qëllimin e dikujt përmes teknikave mendore. «Forca qoftë me ty» u interpretua madje edhe nga disa të krishterë të sinqertë (por sinqerisht të gabuar) si Jezusi duke qenë «Forca» e vërtetë. Një promovim i tillë i atribuon Jezusit karakteristika që e shtrembërojnë dhe e poshtërojnë karakterin e Tij sikurse na parqitet në Shkrimin e Shenjtë – duke rezultuar në një «tjetër Jezus». *Luftërat e Yjeve* ambalazhoi besime dhe praktika të hinduizmit në një sagë fantashkencë të teknologjisë së lartë. Obi Uan ishte një magjistar; Joda ishte një praktikuese e jogës nga pamja dhe praktika dhe kjo seri filmash jashtëzakonisht e suksesshme e shtyu misticizmin lindor në mendjet e të rinjve perëndimorë. *Avatarit* bën të njëjtën gjë për shamanizmin.

Shamanizmi është feja e natyrës dhe e frymërave dhe është më e përhapura nga të gjitha fetë në botë. Ai gjendet midis çdo grupi indigjen kudo në tokë dhe besimet e teknikat e tij janë të njëjta kudo që gjendet. Kjo për shkak të faktit se shamanizmi është një praktikë që vjen nga fusha e frymërave, ku vetë frymërat nuk janë të kufizuara nga vendndodhjet gjeografike të largëta. Termi *shaman* vjen nga populli Tungus i Siberisë dhe parapëlqehet nga antropologët mbi «magjistar i fisit», «mjek popullor magjistar», «shtrigan», «magjistar» etj. Sipas autoritetit të shquar, Majkëll Harner, një antropolog dhe shaman, «një shaman hyn në një gjendje të ndryshuar të ndërgjegjes me vullnet për të marrë njohuri, fuqi dhe për të ndihmuar njerëz të tjerë. Shamani ka të paktën një, dhe zakonisht më shumë,

“frymëra” në shërbimin e tij personal. Për të kryer punën e tij, shamani mbështetet mbi fuqi të veçanta, personale që sigurohen zakonisht nga frymërat e tij mbrojtëse dhe ndihmëse».

Avatarit është një platformë madhështore për të predikuar shamanizmin. Subjekti nuk është as unik, as i ndërlikuar. Një planet hënor i largët i quajtur Pandora është kolonizuar nga një korporatë që është duke gërmuar për një metal që ka një vlerë të madhe për tokën, që ka qenë duke u shkatërruar nga shpërdorimi i burimeve të veta natyrore. Megjithëkëtë, ndërmarrja është penguar nga një fis humanoidësh indigjenë të quajtur Na'vi, fshati dhe toka e të cilëve mbulojnë pjesën qendrore të metalit të çmuar. Përpjekjet diplomatike për ta bindur fisin Na'vi që të shpërngulen gjetkë kanë përfunduar me dështime, kryesisht për shkak të fesë së shamanizmit që ka fisi Na'vi. Ata adhurojnë Eivan, një perëndeshë të ngjashme me atë që grekët e quajtën Gaia ose Nëna Tokë. Eiva del se është një forcë hyjnore, jopersonale që është përgjegjëse për ruajtjen e ekuilibrit të të gjithë jetës. Çdo gjë në Pandora lidhet me Eivan, në mënyrë mistike dhe biologjike. Aspekti biologjik thekson natyrën kritike të ruajtjes së sistemit fizik dhe ekologjik të planetit për mbijetesë të ardhshme. Për të demonstruar lidhjen e të gjitha formave të jetës, frymërat e kafshëve që vriten për ushqim ose për vetëmbrojtje trajtohen nga fisi Na'vi qoftë me falënderim ose duke kërkuar falje.

Asgjë e këtij lloji nuk gjendet midis njerëzve. Sipërmarrja e punimeve minerale mbrohet nga ushtarë mercenarë të cilët po pajisen për ta larguar fisin Na'vi nëse ata refuzojnë përfundimisht për ta liruar tokën e tyre.

Heroi i filmit është një ish-detar paraplegjik (Jake Sully), i cili i mëson zakonet e fisit Na'vi duke përdorur një trup hibrid Na'vi-njeri, një krijim i një bioteknologjie jashtëzakonisht të përparuar. Ai quhet një *avatar*. Xhejku, në trupin e tij avatar, pranohet nga fisi Na'vi për shkak të disa shenjave fillestare se ai është i miratuar për një qëllim nga Eiva dhe nga frymërat.

Regjisorit dhe autori Xhejms Kameruni (James Cameron) e bën mjaft të qartë prirjen e tij teologjike (dhe ekologjike) në pothuaj çdo imazh të filmit. Titulli i filmit dhe imazhi i një Na'vi janë marrë nga perëndia hinduiste Krishna, një avatar i rimishëruar me lëkurë blu i perëndisë Vishnu. Hinduizmi mëson se gjatë gjithë historisë shfaqen avatarë [mishërim i hyjnisë] në forma njerëzore dhe/ose të kafshëve për të restauruar balancën e së mirës dhe së keqes. Theksimi nëpër pemë i filmit është krejt në përputhje me shamanizmin. Pema-shtëpi e stërmadhe

që strehonte klanin Na'vi dhe që shkatërrohet nga sulmi i njerëzve është përfaqësuese e Eivas duke siguruar për klanin Na'vi përmes «Nënës» natyrë. Pema e Shpirtrave lumineshente, që siguron komunikim të drejtpërdrejtë me Eivan, është gjithashtu një qendër fuqie që mund t'i transferojë shpirtrat në trupa të tjerë. Në shamanizmin tradicional, pema është një medium universal komunikimi për ato kultura që të lidhen me shamanë të vdekur, me stërgjyshër dhe me vetë frymërat.

Kameruni i ka shtuar shamanizmit anas shtrembërimin e tij duke bërë që fisi Na'vi të komunikojë me Eivan, frymërat dhe kafshët përmes fibrave optike në bishtalecat e endur. [Humanoidët] Na'vi i futin flijet në vende të ngjashme që gjenden te kafshët dhe bimët. Edhe pse në kundërshtim me praktikën aktuale të shamanizmit, kjo pasqyron domosdoshmërinë e «përfjetimit» të një perëndie që nuk mund të «njihet» përmes arsyes, intelektit apo shkencës. Kjo edhe zgjidh një problem për regjisorin Kamerun. Në atë që ishte pa dyshim një vendim që kishte të bënte me shitjen e biletave, ai e shmang metodën që përdoret zakonisht nga shamanët për të kontaktuar frymërat, që është thithja ose pirja e drogave halucinogjene. Nëse ata të fisit Na'vi «do të merrnin drogë», atëherë kjo do ta kishte hequr *Avatarin* nga klasifikimi PG-13, duke eliminuar çdo grupmoshë që prirret ta shikojë një film të tillë shumë, shumë herë, përveç që është edhe një konsumator kryesor i mallrave që kanë lidhje me *Avatarin*.

Në shamanizmin e vërtetë, nuk ka asnjë «lidhje» fizike apo lidhje biologjike të drejtpërdrejtë me frymërat. Frymërat janë genie jofizike. Përveç drogave që merren për të shkaktuar një gjendje të ndryshuar të ndërgjegjes, lidhja me frymërat është një proces mendor. Mirëpo devijimi i Kamerunit nga shamanizmi i vërtetë të çon përfundimisht drejt besimit tek Eiva. Dr. Grejs Augustine (Grace Augustine), femra shkencëtare në film, shpall se çdo i ashtuquajtur fenomen frymëror që ajo ka vëzhguar në Pandora mund të shpjegohet biologjikisht. Mirëpo, në fund, Dr. Grejs pëson një shndërrim. Ndërsa dergjet duke vdekur nën Pemën e Shpirtrave, fjalët e saj të fundit janë ato të një materialisti që e lejon «përvojën» e saj për të shkelur «shkencën» e saj teksa shpall besimin e saj në perëndeshën pananteiste të fisit Na'vi: «Eiva – unë e shoh atë. Ajo është reale!». Greis u bë çfarë C. S. Ljuis e ka përshkruar si vepra ideale e Satanit – një «magjistar materialist». Ajo iu nënshtrua një perëndie «Forcë» pa pranuar realitetin e frymërave personale mbrapa një genie të tillë, d.m.th., demonë. Xhejku, nga ana tjetër, edhe pse fillimisht e pati neveri atë që e quajti «përfaqim me pemët» nga ana e fisit Na'vi, ia beson plotësisht veten mënyrës së tyre «natyrale» të jetesës dhe nënës së tyre perëndeshë Eiva.

Mbasi lexova me dhjetëra e dhjetëra komente nga të rinjtë të dashuruar me teologjinë e *Avatarit*, është e qartë se ungjilli i tij i rremë po gjen tokë pjellore në mbarë botën ndërsa i paraqet dhe i tërheq milionat e

amatorëve të kinemasë drejt shamanizmit.

Xhejms Kameruni ka paraqitur atë që Bibla e quan «doktrinë të demonëve», që përhapet nga Satani, ati i gënjeshtrave, dhe që mësohet drejtpërdrejt nga demonët. Besimet pagane të Kamerunit janë diametralisht të kundërta me atë që mëson Bibla. Veç kësaj, pikëpamja e tij idealiste e pastërtisë së natyrës e një fisi indigjen si Na'vi është propagandë e pastër (shih intervistën time me një ish-shaman Yanamamo në THEB 11/03). Besimi se natyralizmi prodhon një jetë harmonie, frytëzimi dhe paqeje është një gënjeshtrë që mësohet nga shumë antropologë dhe që, njëkohësisht, kundërshtohet nga përvoja e çdo shoqërie shamanike kudo ku mund të gjenden. Si mund të jem kaq i sigurt? Çdo grup indigjen përbëhet nga njerëz, të cilët, si të gjithë njerëzit kudo, janë mëkatarë. Kjo e keqe e lindur, për më tepër, përzihet nga frymëra gënjeshtrare që kanë si qëllim t'i mashtrorjnë dhe shkatërrojnë njerëzit që e vendosin veten nën skllavërinë e tyre. Asnjë antropolog nuk ka prodhuar deri më sot një fis që të jetë një përjashtim nga kjo gjendje shkatërruese.

DHE FRYMA E THOTË SHKOQUR SE
NË KOHËT E FUNDIT DISA DO TA
MOHOJNË BESIMIN, DUKE U VËNË
VESHIN FRYMËVE GËNJESHTRARE DHE
DOKTRINAVE TË DEMONËVE.

– 1 Timoteut 4:1

Kameruni ka të drejtën e vet të predikojë ungjillin shamanik të *Avatarit*. Të krishterët, nga ana tjetër, duhet të informohen se me çfarë po ushqehen bashkë me kokoshkat tepër të shtrenjta. Është një mungesë e përgjithshme e mprehtësisë dalluese midis tyre që është shpesh acaruese dhe frymërisht tradhtarë për brezin e ardhshëm të besimtarëve. Pjesa acaruese ka të bëjë me ato raste kur besimtarë deklarues përpiqen ta lexojnë krishterimin nëpër filmat e famshëm që janë krejtësisht kundër Krishtit. Kjo ndodhi me *Luftërat e Yjeve*, me serinë *Heri Poter* (Harry Potter) dhe shumë të tjerë për t'u shkruar. Është një rezultat i pashmangshëm se do të shohim të njëjtin gjë për *Avatarin*. [Revista] «*Krishterimi Sot*», për shembull, shpesh i hap rrugën mashtrimeve më të famshme në botë duke i vajosur si të krishtera. Në blogun që ajo mbështet dhe që u drejtohet grave dhe titullohet *Heromenautics* (në mënyrë ironike një lojë me fjalën që nxit interpretimin e saktë të Biblës), një studente femër nga «Seminary Princeton» shkruan kryeartikullin, duke sugjeruar se karakteri i Grejsit (i përmendur më lart) mund të ketë qenë «karakter i krishterë i *Avatarit*» dhe më pas shton një kufizim, «Epo, e krishterkë (ang. Christian-ish), sidoqoftë».

E krishterkë?! Xhejms Kameruni do të tmerrohej nga ky sugjerim; unë jam i zemëruar. E vetmja përfshirje e diçkaje «të

krishterë» në tërë filmin është emri i një vargmali pluskues («Aleluja») dhe përmendja e emrit të Zotit, që është përdorur si një fjalë mallkimi. Kjo është edhe një paradoks për një tregim të vendosur mbi një mijë vjet në të ardhmen, siç duket shumë larg misionarëve me përmbajtje fetare që supozohet se «dëmtonin pastërtinë» e mizorëve fisnikë. Ndonëse është e qartë se krishterimi është zhdukur në mjedisin e ardhshëm të filmit, në mënyrë ironike Perëndia i tij [krishterimit] vazhdon të jetë në psikikën dhe në buzët gojëndyrë të karaktereve në film.

«*Krishterimi Sot*», «Lëvizja e Kishës Emergjente», plani global P.E.A.C.E. i Rik Uorenit dhe ata midis disa misioneve dhe organizatave parakishtarë (d.m.th., ata që ndjekin drejtimin dhe mësimet e C. Peter Wagner) kanë një dobësi për t'u përpjekur të gjejnë grimca të varrosura të Krishtit në një kulturë ose ta përshtatin krishterimin me kulturën dhe anasjelltas. Shumë janë pranë shenjtëritimit dhe shpengimit të paganizmit në një shoqëri, ose të paktën të përpigjen të harmonizohen dhe të punojnë me të gjitha fetë. Kjo është e gjitha tagji për sinkretizmin dhe ekumenizmin. Ata janë duke kontribuar për fenë e Antikrishtit. A. W. Tozeri e qortoi një përpjekje të tillë duke treguar se Moisiu nuk hyri në një panel diskutimi me izraelitët për të gjetur ndonjë meritë frymërore për vëcin e artë, as Elia nuk pati shkëmbime të mendimeve ndërtime me profetët e Baalit dhe as Jezusi nuk kërkoi një takim që të binte në një mendje me farisenjtë. Veç kësaj, promovimi i një «përfaqimi grupi» midis feve kontradiktore me qëllimin për të zgjidhur problemet e botës është një mashtrim i madh në rastin më të mirë. Isaia, duke folur për Perëndinë Jehova, e bën absolutisht të qartë pikëpamjen e Tij: «Përmbahuni ligjit dhe dëshmisë! Në rast se një popull nuk flet në këtë mënyrë, kjo do të thotë se ai nuk ka dritë» (Isa. 8:20).

Gjithashtu paralajmërimet në Fjalën e Perëndisë janë të qarta se po ndodh një luftë e madhe frymërore kudo përreth nesh, që ne jemi në ditët e apostazisë së shfrenuar brenda kishës dhe që po përballemi në botë me një anti-krishterim në rritje. Atëherë, çfarë duhet të bëjë një besimtar? Ne duhet të ndjekim me zell programin mbrojtës dhe parandalues të Zotit, thelbi i të cilit gjendet në Psalmi 1: «Lum njeriu që nuk ecën sipas këshillës të të pabesëve, që nuk ndalet në rrugën e mëkatarëve dhe nuk ulet bashkë me tallësit, por që gjen kënaqësinë e tij në ligjin e ZOTIT, dhe që mendon thellë ditë e natë mbi ligjin e tij. Ai do të jetë si një pemë e mbjellë gjatë brigrive të ujit, që jep frytin e tij në stinën e tij dhe të cilin gjethet nuk i fishken; dhe gjithçka bën do të ketë mbarësi». Por, sigurisht, ka më shumë: lutja dhe përbashkësia, për shembull. Ne duhet t'i vëmë në lëvizje qerret herë pas here – për mbrojtje frymërore, për këshilla, inkurajim dhe t'i shërbejmë njëri-tjetrit. Nëse këto gjëra bëhen praktika jonë e disiplinuar e jetës, edhe pse apostazia e than mjedisin frymëror përreth nesh, ne dhe familjet tona do të jemi gjithsesi të frytshëm në Zotin. **THEB**



THIRRJA PËR DISHEPULLIM

Nga *Një Thirrje Urgjente për një Besim Serioz* – nga Dave Hunt

SHOHIM NGA FJALA E PERËNDISË se mëkatarëve të humbur u ofrohet falje për çdo mëkat (të shkuar, të tashëm e të ardhshëm) dhe jeta e përjetshme si dhuratë e hirit të Perëndisë me anë të virtytit të veprës shpenguese të kryer plotësisht nga Krishti në kryqin e Kalvarit dhe ringjalljes së Tij trupore. Për të marrë këto dhurata shumë të çmuara një person mjafton të besojë tek ungjilli – që është mëkatar dhe që meriton gjykimin e Perëndisë, duke qenë i paaftë me anë të përprjekjeve vetjake, riteve fetare apo ndonjë mënyre tjetër për të siguruar apo fituar shpëtimin qoftë edhe pjesërisht; dhe se Krishti e pagoi borxhin e plotë që kërkon drejtësia e Perëndisë për mëkatin e njeriut. Sigurisht, një person duhet ta besojë ungjillin jo thjesht si fakt historik, por deri në atë pikë sa të vendosë plotësisht besimin në Zotin Jezus Krisht si Shpëtimtarin vetjak për përjetësinë.

Krishti i drejtoi dishepujt e Tij që t'i predikonin lajmin e mirë të ungjillit secilit në çdo vend. Ky urdhër ndaj ndjekësve të Tij të parë është bërë i njohur si «Mandati i Madh». Ai pohohet në dy mënyra: «Dilni në mbarë botën dhe [...] predikoni ungjillin» (Marku 16:15); dhe «bëni dishepuj» (Mateu 28:19, 20). Ata që predikojnë ungjillin duhet të dishepullojnë ata që e besojnë atë. Të rilindur nga Fryma e Perëndisë në familjen e Tij (Gjoni 3:3-5; 1 Gjonit 3:2), të konvertuarit fillojnë një jetë të re si ndjekës të Krishtit, të zellshëm për të mësuar nga Ai dhe për t'iu bindur Atij të cilit i detyrohen një borxh të pafund mirënjohjeje.

Krishti paralajmëroi se disa do të duken se do ta pranojnë ungjillin me entuziazëm të madh vetëm për t'u përzier në botë, duke u shkurajuar dhe zhgënjyer. Ata përfundimisht do të reshtnin së ndjekuri Atë. Shumë ruajnë një pamje të jashtme të krishterimit pa realitet të brendshëm, duke mashtruar madje edhe veten. Ata, të pabindur kurrë plotësisht në zemrat e tyre, prapëseprapë nuk janë gati të pranojnë mosbesimin e tyre. Pali paralajmëroi: «Analizoni veten tuaj a jeni në besim» (2 Korintasve 13:5).

Nga ata që janë të vërtetë, shumë pak janë në gjendje të japin një arsye për shpresën që është në ta (1 Pjetrit 3:15). Sa të krishterë janë në gjendje t'i mbushin mendjen me bindje një ateisti, budisti, hinduisti, myslimani apo përkrahësi të filozofisë së epokës e re, me prova mahnitëse dhe arsye të shëndosha nga Shkrimi? Fjala e Perëndisë është shpata e Frymës, por pak e njohin mjaft mirë për të shuar dyshimet e tyre, aq më pak t'i kthejnë në këtë besim të tjerët.

Një prej nevojave më të mëdha të sotme është për mësues të fortë biblik që prodhojnë dishepuj të cilët janë në

gjendje të «luftojnë për besimin, që u qe transmetuar shenjtorëve një herë e përgjithmonë» (Juda 3). Ai besim për të cilin duhet të luftojmë u transmetua nga Krishti te dymbëdhjetë dishepujt e parë, të cilët duhej t'ua mësonin atyre që i ungjillëzonin që «të zbatojnë të gjitha gjërat» që u kishte urdhëruar Krishti.

Përmes brezave pasues (duke filluar me dishepujt e parë dhe ata të cilëve ata i çuan në besim te Krishti dhe i dishepulluan) ata që ishin fituar për Të dhe nga ana e tyre, duke iu bindur Zotit të tyre, dishepulluan të tjerë, ky zinxhir i pakëputur i urdhrit vjen deri te ne në kohën tonë. Jo ndonjë prift i veçantë apo klasë kleri, por çdo i krishterë sot, ashtu si ata që kanë kaluar më parë, është një pasardhës i apostujve. Mendo pak se çfarë do të thotë kjo!

Në thelb të thirrjes së Krishtit për dishepullim është zbatimi i përditshëm i kryqit të Tij në jetën e besimtarit. Megjithatë rrallë dëgjohet në qarqet ungjillore shpallja përfundimtare e Krishtit: «Dhe kush nuk e mbart kryqin e vet dhe nuk më ndjek [...] [dhe] nuk heq dorë nga të gjitha ato që ka, nuk mund të jetë dishepulli im» (Luka 14:27-33). Thirrja për dishepullim duhet të përballet me sinqeritet. Përmes kryqit ne vdesim për veten tonë dhe fillojmë të jetojmë për Zotin tonë në fuqinë e ringjalljes (Galatasve 2:20). Në të vërtetë vdekja e Krishtit në kryq do të kishte qenë një akt i kotë nëse nuk do të sillte jetë të re, për tani dhe për tërë përjetësinë.

Jeta e ringjalljes e llogarit jetën e vjetër të vdekur dhe nuk parashikon gjë për mishin (Romakëve 6:4, 11; 13:14). Në vend të vetëvlerësimit popullor, Perëndia na thërret të mohojmë veten, të duam të vërtetën dhe të urrejmë marrëzinë, t'i pëlqejmë Perëndisë në vend të të tjerëve apo vetvetes, pavarësisht nga kostoja në këtë jetë. Mos shiko trysninë shoqërore me atë që mendojnë, thonë apo bëjnë. Ne duhet të jemi plotësisht të bindur se ajo që Perëndia mendon dhe ajo që Ai do të thotë kur të shfaqemi para Tij një ditë është ajo që ka rëndësi.

Xhim Elioti, një prej pesë dëshmorëve të vrarë në Ekuador më 1956, tha se kur ishte i ri zgjodhi fushën e misionit në vend të karrierave më të njohura: «Nuk është i marrë ai që dorëzon atë që nuk mund të mbajë për të fituar atë që nuk mund të humbasë». Ajo zgjedhje është e logjikshme vetëm nëse dikush beson se koha është e shkurtër dhe përjetësia e pafund. Një zotim i tillë sjell gëzim e paqe qiellore dhe një përmbushje të tillë, që askush në tokë nuk mund ta ofrojë.